



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

04 Nr. 451-19199/20
Data 30/07 2020

Në bazë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës, miratuar nga Kuvendi Komunal, me nr.01 Nr. 06-8132/ 2020 të datës 4.3.2020, dhe Vendimit të Asambles Komunale nr.01-06-4728, dt.05.02.2020, Drejtorja e Arsimit në Klinë shpall :

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KLINËS

Sipas këtij konkursi ndahen 30 (tridhjetë) bursa për studentë të dalluar të Komunës së Klinës në vlerë prej 50€, për vitin akademik 2019-2020.

I. KUSHTET DHE KRITERET E APLIKIMIT

Për fitimin e bursave të studimeve kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatët që i plotësojnë kushtet si në vijim:

- 1.1 Të jenë studentë të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës, por jo edhe ata me vetëfinancim, korrespondencë, studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë;
- 1.1 Të jenë studentë të rregullt, të vitit të 2-të e më lart,
- 1.2. Të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës.
- 1.3 Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
- 1.4 Të jenë studentë që nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër nga buxheti i Kosovës si dhe të mos jenë të punësuar në institucione publike;
- 1.5 Studentët që nuk janë përsëritës të vitit.
- 1.6 Studentë që kanë notën mesatare 7.5 e më të lart, përveç studentëve të profileve deficitare, si në pikën 1.7 të këtij neni;
- 1.7 Përparësi në fitimin e së drejtës për bursë do të kenë studentët që studiojnë në **lëmënjtë deficitare** (Fakulteti i Mjekësisë- Drejtimi i Përgjithshëm, Stomatologji, Infermieri, Mami, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti Inxhinerisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinerisë Mekanike, Drejtim të Matematikës-profil Arsimit dhe Drejtime të Fizikës-profil arsimor).

II. KRITERET DHE PËRPARËSITË E PËRFITIMIT TË BURSËS`

1. Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, kandidati vlerësohet me pikë si në vijim:

1. Poentimi vlerësohet me po aq pikë sa është nota mesatare e studentit;
2. Përparësi në start kanë profilet deficitarë si nga pika 1.7 të cekur më lart në këtë konkurs, do të poentohen me 5 pikë bonus.

Sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta të cekura në pikën 1 dhe 2, të nenit II, do të kenë përparësi:

- 1) Studentët fëmijë i dëshmorit, të viktimave civile të luftës, të veteranit dhe të invalidëve të luftës;
- 2) Studentët me aftësi të kufizuar;
- 3) Studentët e gjinisë femërore.

III. Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humb të drejtën e shfrytëzimit të bursës.

IV. Studenti përfitues i bursës obligohet ta kthejë bursën e komunës, nëse konstatohet se merr bursë nga ndonjë njësi tjetër buxhetore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim (të gjitha origjinale):

- Certifikata e notave,
- Vërtetimin se studenti ka regjistruar semestrin e fundit për vitin akademik 2019/2020 si student i rregullt,
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë, vëlla, motër e dëshmorit, apo person me nevoja të veçanta.

Vërejtje:

Konkursi mbetet i hapur për aplikim **15 ditë nga dita e publikimit zyrtar në faqen zyrtare të komunës.**

Të gjithë studentët e interesuar duhet të marrin aplikacionin në DKA dhe të plotësuar bashkë me dokumentacionin tjetër t'i dorëzojnë në Drejtorinë e Arsimit në Klinë gjatë orarit zyrtar të punës (8- 16).

Kundër vendimit të shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet komisionit të ankesave, i formuar "ad hoc" me vendim të Kuvendit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.



Drejtori i DKA-së

Enver Gashi